

REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

(projekt)

(Nr. _____ datë _____ 2021)

PËR

**"KRITERET DHE PROCEDURAT PËR KRIJIMIN E REZERVAVE STRATEGJIKE
TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË (TË PAPRERË), RUAJTJEN DHE TRAJTIMIN E
PYJEVE TË VIRGJËR OSE POTUAJSE TË VIRGJËR, SI DHE KALIMIN E TYRE
NË KONSERVIM TË PLOTË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 32, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, "Për pyjet", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e kritereve dhe procedurave për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), ruajtjen dhe trajtimin e pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër, si dhe kalimin e tyre në konservim të plotë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi
2. Rezervat strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë) si sipërfaqe pyjore të vëna në ruajtje për të përballuar ngjarje madhore, krijojen nga ngastrat dhe nënngastrat pyjore të cilat plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) të kenë një sipërfaqe jo më pak se 10 % të sipërfaqes pyjore dhe /ose 15 % të vëllimit të lëndës drusore të pyjeve publikë, në pronësi të njësive të vetqeverisjes vendore;
 - b) të shfrytëzohen vetëm për plotësimin e nevojave të popullatës dhe të institucioneve publike për furnizimin me dru zjarri e lëndë ndërtimi, në rastet e ngjarjeve madhore;
 - c) të jenë sa më afér qendrave të banuara dhe të kenë një shpërndarje homogjene, sipas ndarjes administrative të territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - d) të jenë të përshkueshme me rrjet rrugor funksional, që mundëson përdorimin e tyre në çdo kohë, dhe të mos jenë në zona me rrezikshmëri të lartë për t'u prekur nga zjarri;
 - e) të menaxhohen në përputhje me objektivat e përcaktuara në planet e mbarështimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.

3. Rezervat strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), administrohen nga njësitë e vetqeverisjes vendore përkatëse.

4. Për krijimin e rezervave strategjike ndiqet procedura si vijon:

a) Brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, njësitë e vetqeverisjes vendore, nëpërmjet strukturave përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve, përcaktojnë ngastrat dhe nëngastrat që do të shërbejnë si rezerva strategjike të lëndës drusore në këmbë, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtj vendimi;

b) Ngastrat dhe nëngastrat të përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike, dërgohen për vlerësim teknik në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, e cila, brenda 2 (dy) muajve, ia përcjell strukturës përgjegjëse për pyjet, në Ministri;

c) Struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, pasi vlerëson që përcaktimi i ngastrave dhe nëngastrave në shkronjën "a", është në përputhje me programet dhe dokumentat strategjikë për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve, si dhe plotëson kërkesat e këtij vendimi, ia përcjell për miratim ministrit, krijimin e rezervës strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë).

5. Në rezervat strategjike të miratuara ndalohet të kryhen ndërhyrje silvikulturore, me përjashtim të prerjeve shëndetësore, ndalohet kullotja, ndezja e zjarreve, dhënia në përdorim, heqja nga fondi pyjor si dhe ushtrimi i veprimitarive të tjera të çfarëdo lloji.

6. Ruajtja dhe trajtimi i pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër, të cilët janë të përcaktuara në planet e mbarështimit të ekonomive, grumbujve dhe drurëve pyjore të veçantë të cilësuara të virgjër ose pothuajse të virgjër, bëhet sipas kritereve të mëposhtme:

- a) ruajtjen e funksioneve ekologjike, mjedisore dhe evolucionin e tyre;
- b) përbushjen e objektivave për mbarështrimin e ekonomive, grumbujve dhe drurëve pyjore të veçantë të cilësuara të virgjër ose pothuajse të virgjër;
- c) vendosjen e masave të nevojshme mbrojtëse për mbajtjen ose rivendosjen në një status të favorshëm ruajtjeje për të siguruar mbrojtje afatgjatë të pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër;
- d) përjashtimin nga shfrytëzimi dhe nga çdo lloj ndërhyrje tjetër që cënon statusin e tyre;
- e) të jetë në përputhje me planet e mbarështimit.

7. Ngastrat dhe nëngastrat në pyjet të virgjër ose pothuajse të virgjër, identifikohen nga njësitë e vetqeverisjes vendore, sipas informacionit të kadastrës pyjore dhe menaxhohen sipas rekomandimeve të planeve të mbarështimit.

8. Pyjet e virgjër ose pothuajse të virgjër të identifikuar sipas pikës 7, kalojnë në konservim të plotë, bazuar në kriteret ndërkombëtare për konservimin e natyrës sipas IUCN (Unioni Nërkombëtar për Konservimin e Natyrës).

9. Për kalimin e pyjeve në konservim të plotë, ndiqet procedura si vijon:

- a) Njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet strukturave përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve, identifikojnë ngastrat dhe nëngastrat e pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër që do të kalojnë në konservim të plotë;
- b) Propozimi për kalimin në konservim të plotë të pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër, bëhet pas konsultimit me komunitetin e zonës pyjore dhe aktorët e tjerë të interesuar si dhe miratimit nga këshilli bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ndodhet zona pyjore;
- c) Ngastrat dhe nëngastrat të identikuara në shkronjën "a" të kësaj pike, dërgohen për vlerësim teknik në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, e cila brenda 2 (dy) muajsh, ia përcjell strukturës përgjegjëse për pyjet, në Ministri;
- d) Struktura përgjegjëse për pyjet, pasi vlerëson që përcaktimi i ngastrave dhe nëngastrave në shkronjën "a", është në përputhje me programet dhe dokumentat strategjikë për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve, si dhe plotëson kërkesat e këtij vendimi, ia përcjell për miratim ministrit, kalimin në konservim të plotë të pyjeve të virgjër.

10. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 734, datë 1.9.2010 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave, për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë", shfuqizohet.

11. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi RAMA